

Planet rregulluese te Prishtinës

Utopi apo realitet?

Drejtoresha e Iniciativës Kosovare për Stabilitet (IKS), Besa Shahini, thotë se një plan i mirë duhet t'i adresojë problemet e tanishme të qytetarëve të sotëm, e jo ato të një qyteti të imagjinuar utopik të një të ardhmeje të largët. Ndërsa, drejtori i Planifikimit në Komunën e Prishtinës, Lulëzim Nixha, thotë se planet rregulluese të Prishtinës nuk mund t'i vlerësojnë "joprofesionistët"

VISAR KRASNIQI
"Vizione utopike". Ky është vlerësimi i parë që u ka bërë Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) planeve rregulluese të Komunës së Prishtinës. Komunarët e mohojnë këtë. Thonë se planet e tyre janë realiste. "Lajmi" ka ballafaquar drejtorin komunal të Planifikimit, Lulëzim Nixha, me drejtoreshën e Institutit "IKS", Besa Shahini. Sipas Shahinit, IKS i ka studiuar të gjitha planet, të cilat i

ka marrë nga vetë drejtori Nixha. "Gjatë studimit të tyre i kemi parë se janë plane utopike". Shahini merr një shembull për lagjja "Kalabria". Sipas planit të Komunës, ajo thotë se në atë lagje parashihet të rënohen shumë shtëpi dhe të bëhet një zonë e gjelbëruar, një lagje e re. "Parashihet të ndërtohen shumë ndërtesa të larta, ndërsa nuk janë pyetur qytetarët nëse dëshirojnë të jetojnë në to". Ajo thotë se asnjë plan urbanistik nuk mund të bëhet pa aprovimin e qytetarëve. Por, Nixha thotë se për të gjitha planet ka pasur diskutim me qytetarët. Ai nuk pajtohet në asnjë segment se planet janë utopike. "A ka qenë utopi kur është thënë se njeriu mund të shkojë në hënë. Këto plane janë planifikuar për 15 vjet". Duke u mbështetur në hulumtimet dyvjeçare në Komunën e Prishtinës, Shahini këmbëngul se në Prishtinë nuk ka më shumë se 220 mijë banorë. "Ndërsa Prishtina

ka bërë plane për 600 mijë banorë. Deri në vitin 2020 Prishtina nuk mund ta rrisë numrin e banorëve për 100 për qind". Për Nixhën janë të habitshme hulumtimet e IKS-it rreth numrit të banorëve. "Prej nga këto të dhëna. Cili demograf i ka këto të dhëna? Nuk besoj që Prishtina i ka 220 mijë banorë. Të dhënat janë të pasakta". Nixha nuk pajtohet me konstatimet e IKS-it se gjatë ditës në Prishtinë hyjnë mesatarisht 12.000 vetura. "Në Prishtinë gjatë ditës hyjnë 80 mijë vetura". Me planet e reja Shahini thotë se nuk është arritur të ruhet trashëgimia kulturore e Prishtinës. "Në fakt, neglizhenca dhe shkatërimi kanë vazhduar. Nëse e shohim për më afër listën e 21 monumenteve, shfaqet një pasqyrë edhe më e zymtë. Një ndërtesë nën mbrojtje është shkatërruar për t'ia lëshuar vendin zyrave të reja të PTK-se (rruga e UÇK-së, nr. 66)". Hulumtuesit e IKS-it kanë shikuar se prej 76

monumenteve më se 19 ndërtesa janë zhdukur prej vitit 2001. Shahini thotë se gjatë hulumtimit ka pasur debate me komunarët. "Krejt debatet i kemi bërë në komunë, por ata kurrë nuk janë pajtuar me komentet tona". Por, Nixha thotë se nuk i ka pranuar përfaqësuesit e IKS-it për debat. Drejtuesit e IKS-it i quan joprofionalistë për t'i vlerësuar planet. "Asnjëri prej tyre nuk është arkitekt, së paku". Ndërsa, drejtoresha Shahini thotë se kanë takuar përplues të politikave publike, biznesmenë, studentë dhe zyrtarë komunalë për t'i zbuluar trendet zhvillimore dhe për t'i shikuar çështjet prej trashëgimisë kulturore të Prishtinës e deri te zhvillimi ekonomik dhe planifikimi urbanistik. Ajo thotë se Prishtina duhet të jetë gati me projekte edhe pas përcaktimit të statusit të Kosovës. "Qëllimi kryesor është arritja e një konsensusi për një qeverisje më të mirë të qytetit". Ndërsa, drejtori Nixha thotë se pas statusit do të fillojë realizimi i projekteve që Prishtina i ka bërë gati.



Besa Shahini

Besa Shahini: Komuna të bashkëpunojë me vetveten

Drejtoresha ekzekutive e IKS-it, Besa Shahini, thotë se është vendimtare që plani i mirë të jetë edhe i zbatueshëm. "Kjo nënkupton një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet drejtorëve të ndryshme komunale, institucioneve komunale dhe atyre qendrore, si dhe organizatave që ende varen nga AKM-ja (si për shembull ndërmarrjet publike)". Ajo thotë se një bashkëpunim i tillë ka munguar deri më sot.



Lulëzim Nixha

Lulëzim Nixha: Pas planeve, flasim për fasada

Kryearkitekti i Prishtinës, Lulëzim Nixha, thotë se nëse Komuna merr kredi, atëherë Prishtina do të ndërtohet shpejt. "Ne kemi formuar lagje të reja me këto plane, Kalabrinë, Arbërinë, e ka shumë kërkesa për ndërtime të reja. Por, duhet të marrim kredi afatgjate, që janë të leverdshme". Sipas tij, planifikimi është një detyrë se deri ku mund të arrihet. "Nëse ke bërë një model, ke për të arritur një projekt". Ai thotë se pas Planit Zhvillimor Strategjik dhe planeve rregulluese, do të hartohen planet detale urbanistike. "Atëherë mund të flasim për fasada e ngjyra".

FOTO: KORAB BASHA